



Primar / Dorezuar Punëdhësi/Prodator Receiver/Deliverer	23.06	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHKIMSHIK	4897/2023		1/9	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.780/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.780/2023 të datës 25.05.2023 të ankuesit me adresë kundër Vendimit KA.nr.18/2023 të datës 18.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.780/2023 e datës 25.05.2023 e parashtruar nga ankues.

II.Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.18/2023 i datës 18.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 03.03.2023 ka shpallur konkursin me numër reference KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-002 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 për Prokurorinë Themelore në Gjakovë (5 pozita). Tutje në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është përfshirë në fazat e procedurës (listën e shkurtër, testin me shkrim dhe testin me gojë), mirëpo pas publikimit të njoftimit për kandidatët e suksesshëm për

Prokurorinë Themelore në Gjakovë të datës 20.04.2023 ankuesi nuk ka rezultuar si kandidatë i suksesshëm në mesin e pesë kandidatëve të suksesshëm.

Ankuesi më datë 11.05.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 18.05.2023 ka nxjerr Vendim me numër KA.nr.18/2023 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit duke i lënë në fuqi njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare për Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër KA.nr.18/2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 25.05.2023 me numër protokollin 4419/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 31.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 05.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën e datës 25.05.2023 me numër protokollin 4419/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare i datës 20.04.2023; Vendimin me numër KA.nr.18/2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.03.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 05.06.2023; Konkurs me referencë KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-002 të datës 03.03.2023 të shpallur për pozitën *Zyrtar Ligjor 2* për Prokurorinë Themelore në Gjakovë (5 pozita); Vendimin DPSKPK/Nr.131/2023 i datës 27.03.2023 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Deklaratën e datës 27.03.2023; Miratimin e datës 27.03.2023; Rekomandimin për emërim i datës 18.04.2023; Raportin Final i Rekomandimin nga Komisioni Rekrutues i Datës 14.04.2023; Formularin MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin e përmbledhjes individuale të testit me shkrim dhe intervistës i datës 14.04.2023; Përmbledhjes e vlerësimeve individuale e intervistës i datës 14.04.2023; Lista e thirrjes në intervistë; Lista e rezultateve të testit me shkrim e datës 07.04.2023; Lista përfundimtare e përzgjedhës të testit me shkrim e datës 07.04.2023; Formularin e përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim i datës 07.04.2023; Formularin MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kritereve të testit me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 03.04.2023; Lista e pjesëmarrësve në testin me shkrim; Njoftimin i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë; Përmbledhja e vlerësimeve individuale të listës së ngushtë e datës 29.03.2023; Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave e datës 29.03.2023; Formularët MAP-SHCK-08a për vlerësimin individuale përfundimtar të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e gjuhës së huaj për ankuesin, kandidaten T.V, A.B, D.B, E.D dhe E.V; Procesverbalin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 12.05.2023; Ankesën e datës 10.05.2023 e parashtruar nga

ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Çelësin e testit me shkrim; Testin me shkrim i datës 03.04.2023 të ankuesit, kandidatëve: T.V, A.B, D.B, Ë.D dhe E.V; Kërkesën për punësim e datës 06.03.2023 e ankuesit, Letër motivimi, CV-në, Diplomën me Nr. 643, Diplomën me Nr. 83, Certifikatën A.GJ.I.nr.43/2020 e datës 24.02.2020, Certifikatën për periudhën mars-qershor 2018, Certifikatën për periudhën 29.06-20.09.2020, Certifikatën nga London School of English, Certifikatën e datës 30.11.2010, Certifikatën e datës 01.03.2010, Letër reference për ankuesin, Referencë e datës 25.09.2019, Letër rekomandim i datës 04.10.2021, Rekomandim i datës 04.10.2021, Letër rekomandimin e datës 09.06.2020, Rekomandimin e datës 20.01.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 06.03.2023 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Dokument identifikimi; Kërkesën për punësim e datës 15.03.2023 e kandidatës T.V, Diplomën me Nr. 563, Dokument identifikimi, Vërtetim nga Universiteti i Prishtinës i datës 14.03.2023, Certifikatën A.GJ.I.nr.66/2020 e datës 24.02.2020, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 14.03.2023 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Marrëveshjen për shërbime të veçanta me Nr. 303 e datës 26.02.2020, Vërtetimin me Nr. 01.30/19 i datës 30.01.2019, Certifikatën Ref.Nr.06/17 e datës 26.05.2017, Certifikatën dhjetor 2017, Certifikatën për periudhën 06-07.11.2020, Certifikatën e datës 02.07.2018, Certifikatën e datës 18.02.2018, Certifikatën për periudhën 05-07.10.2018, Certifikatën e datës 06.06.2022, Certifikatën e datës 19.04.2022, Letër Rekomandimin e datës 25.01.2019, 24.01.2019, Vërtetimin e datës 31.08.2017, Vërtetimin me Nr. prot: 08/2022 i datës 07.02.2022, Referencën e datës 10.02.2020, Referencën e datës 12.02.2020, Referencën e datës 11.02.2020; Kërkesën për punësim e kandidat A.B e datës 10.03.2023, Diplomën me Nr. 840, Diplomën e datës 24.05.2017, Certifikatën e datës 31.01.2023, Referencat për kandidati A.B, Certifikatën maj 2021, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 06.03.2023 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Dokument identifikimi, Certifikatën e datës 07.11.2019, Certifikatën për periudhën 27.02-03.06.2019; Kërkesën për punësim e kandidatit D.B e datës 13.03.2023, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 07.03.2023 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Certifikatën e datës 31.01.2023, Diplomën me Nr. 719, Letër referencës për kandidatin D.B, Rekomandimin e datës 08.03.2023, Referencë për punësim e datës 08.03.2023, Certifikatën për periudhën 10.10.2018 deri 16.01.2019; Kërkesën për punësim të kandidatës Ë.D e datës 14.03.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 07.03.2023 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Certifikatën SKPK.DBNJ/Nr.34 e datës 17.01.2023, Reference për kandidaten Ë.D, Reference Ap.nr.59/2022 e datës 14.11.2022, Kontratë mbi punën e praktikës vollontere e datës 02.08.2021, Dokument identifikimi, Diplomën me Nr. 7586, Certifikatën 2019, Certifikatën e datës 06.04.2018, Diplomën e datës 15.09.2014; Kërkesën për punësim e kandidatit E.V e datës 16.03.2023, Diplomën me Nr. 849, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 03.03.2023 e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Certifikatën SKPK/DBNJ/Nr.35 e datës 05.12.2022, Referencën Ap.nr.60/2022 e datës 14.11.2022, Certifikatën për periudhën 15.02-15.05.2021, Certifikatën me Nr. protokoli 461 e datës 04.07.2017, Diplomën e datës 22.05.2017 Vërtetimin e datë 14.11.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **pabazuar**, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër KA.nr.18/2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendon se përbërja e Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Civil nuk ka qenë e themeluar në pajtim me Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil; Përpilimi i testit me shkrim ka qenë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil; Institucioni i cili publikon konkurs për pozita udhëheqës është i obliguar të njoftoj Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vlerësimi i testit me shkrim nuk është bërë në bazë të përgjigjeve të dhëna nga kandidatët por është bërë në bazë të preferencave; Dy kandidatë të pranuar 4 dhe 5 kanë qenë praktikant në Prokurorin e Themelore në Gjakovës dhe është bërë diskriminim në baza gjinore; Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore.

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se konkursin me referencë KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-002 të datës 03.03.2023 të shpallur për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 2, 5 pozita" në Prokurorinë e Themelore në Gjakovë, kriteret kanë qenë: *Përgatitja profesionale dhe kualifikimi: Diplomë Universitare-Fakulteti Juridik dhe Një (1) vit përvojë të punës profesionale*".

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesi se përbërja e Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Civil nuk ka qenë e themeluar në pajtim me Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës, ka konstatuar se Ushtruesi i Detyrës i Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës përmes Vendimit DPSKPK/Nr.131/2023 të datës 27.03.2023 ka themeluar Komisionin Përzgjedhës të Shërbimit Civil në përbërje prej pesë (5) anëtarësh, ndërsa pozitave të Komisionit Përzgjedhës kanë qenë si në vijim: 1. *E.T-Administrator i Prokurorisë Themelore në Gjakovë-kryesues*; 2. *A.B-Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme, SKPK-anëtar*; 3. *A.F-Bashkëpunëtor Profesional-ZKPSH-anëtar*; 4. *M.M Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore, SKPK-anëtare*; dhe 5. *K.Z-Zyrtar Ligjor, Prokuroria Themelore në Gjakovë-anëtarë*. Marr parasysh faktin që në kuadër të Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Civil nuk ka asnjë anëtar që përmbush aspektin etnik, atëherë sipas paragrafit 2 të nenit 7 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, është përcaktuar se: *"Nëse KPSHC nuk mund të themelohet në bazë të paragrafit 1 të këtij neni. Menaxheri i Njesisë së Personelit të institucionit përkatës përgatit një deklaratë me shkrim ku përshkruan arsyet për mos përmbushjen e kërkesave"*, si rezultat i kësaj meqë nuk është plotësuar kushti që një prej anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Civil të jenë nga radhët e komuniteteve bazuar në dispozitën e lartcekura më datë 27.03.2023 Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës ka nxjerr deklaratë me shkrim me të cilën është arsyetuar që është e pamundur propozimi i një anëtari të komisionit nga radhët të komunitetit tjetër. Rrjedhimisht bazuar në dispozitat ligjore të cekura si më lartë, dhe duke konstatuar gjendjen faktike të themelimit të Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Civil sipas vendimit të lartcekur Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Përzgjedhës në Shërbimin Civil për këtë pozitë është themeluar në pajtim të plotë me nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores

Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: "Institucionet themelojnë një komision përzgjedhës ad-hoc të shërbimit civil (në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarët të cilët kanë pozita më të lartë se pozitat që duhet të rekrutohet, por një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumë etnik dhe përfaqësim gjinor. KPSHC zhvillon procedurat e rekrutimit për pozitat e karrierës dhe të jo karrierës.", kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se përpilimi i testit me shkrim ka qenë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ka shqyrtuar përpilimin e testit me shkrim dhe ka konstatuar se testi me shkrim për këtë pozitë është përpiluar prej tri pjesëve: *Pjesa e njohurive të Përgjithshme, Pjesa e aftësive të përgjithshme dhe të personalitetit dhe Pjesa e njohurive lidhur me vendin e punës*, kështu që meqenëse për këtë pozitë nuk është kërkuar gjuhë e huaj atëherë testit me shkrim përpilohet prej këtyre tri pjesëve siç parashihet me nenin 36 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Po ashtu me rastin e përpilimit të testit me shkrim evidentohet faktin se *Pjesa e njohurive të Përgjithshme* përmban tri (3) pyetje në formë eseje, *Pjesa e aftësive të përgjithshme dhe të personalitetit* përmban dymbëdhjetë (12) pyetje me përgjigje të shumëfishta, ndërsa *Pjesa e njohurive lidhur me vendin e punës* përmban gjashtëmbëdhjetë (16) pyetje prej tyre tetë (8) me përgjigje të shumëfishta dhe tetë (8) në formë eseje, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se me rastin e përpilimit të testit me shkrim janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 36 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se institucioni i cili publikon konkurs për pozita udhëheqës është i obliguar të njoftoj Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka konstatuar se pozita *Zyrtar Ligjor*, nuk është pozitë e nivelit udhëheqës por është pozitë e nivelit profesional siç parashihet me nenin 23 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për më tepër Gjykata Kushtetues e Republikës së Kosovës sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO171/18 të datës 20 maj 2019 ka vendosur lidhur me kushtetutshmërinë e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe si rrjedhojë ka konstatuar se neni 6 paragrafi 1.2 i këtij ligji nuk është në përputhje me Kushtetutën, me çka nënkupton është shfuqizuar funksioni për *mbikëqyrjen e procedurës së përzgjedhjes dhe vendosjen nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislationit për shërbimin civil* i paraparë më nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që pretendimi i ankuesit është i paqëndrueshëm.

Pretendimi ankimor i ankuesit se vlerësimi i testit me shkrim nuk është bërë në bazë të përgjigjeve të dhëna nga kandidatët për është bërë në bazë të preferencave, është i pa bazuar dhe pa argumentuar, ngase Kolegji i Këshillit nga shqyrtimit i formularëve të vlerësimit të testit me shkrim, ka gjetur se ankuesi në testin me shkrim për pozitën *Zyrtar Ligjor 2* në

Prokurorinë Themelore në Gjakovës ka arritur të marr gjithsej 58 pikë, ndërsa gjatë shqyrtimit të vlerësimit të testit me shkrim dhe çelësit të përgjigjeve të testit, rrjedhë se Komisioni Përzgjedhës vlerësimin e testit me shkrim për pozitën *Zyrtar Ligjor 2* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë e ka bërë në pajtueshmëri me nenin 37 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, rrjedhimisht gjatë këtij procesi të vlerësimit të testit me shkrim nuk është vërejtur ndonjë parregullsi e cila mund ta ketë favorizuar respektivisht dëmtuar ndonjërin nga kandidatët në këtë procedurë rekrutimi, ngase ankuesi ka arritur të kaloj këtë fazë dhe është ftuar në fazën tjetër të procedurës, si rezultat i kësaj ftesa për fazën e testimit me gojë është bërë në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 36 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton: *“kandidatët të cilët kalojnë me sukses testin me shkrim ose arrijnë të mbledhin 50% të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë”*.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se dy kandidatë të pranuar 4 dhe 5 kanë qenë praktikant në Prokurorinë Themelore në Gjakovës dhe është bërë diskriminim në baza gjinore, Kolegji i Këshillit, në vlerësim të bazës ligjore, vlerëson se në këtë procedurë të rekrutimit i është dhënë mundësia e barabartë të gjithë kandidatëve të interesuar duke përfshirë kandidatët e të dyja gjinive dhe po ashtu edhe ju është dhënë mundësia e barabartë të gjithë të interesuarve nga ana e të gjitha komuniteteve, rrjedhimisht edhe përmbajtja e konkursit ka qenë e tillë dhe në pajtim me nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse në këtë konkurs nuk është mohuar e drejta për aplikim në këtë rast edhe kandidatët që pretendon ankuesi kanë pasur të drejtë të aplikojnë dhe t’iu nënshtrohen fazave të procedurës dhe varësisht nga rezultatet e treguara në faza të procedurës të marrin edhe vlerësimin e merituar, si rrjedhojë Kolegji, konstaton se nuk është e ndaluar të aplikojnë edhe kandidatët që praktikën e ka përfunduar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë për faktin që nuk ka asnjë dispozitë ligjore që ndalon aplikimin në pozitat përkatëse, ngase shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës, ngase këto janë parime të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të përcaktuar me nenin 5, nenin 11 dhe nenin 18, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Në vështrim të të gjitha pretendimeve ankimore të ankuesit po ashtu edhe me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së procedurës së rekrutimit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe duke u bazuar në nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative”*, do të bëjë shqyrtimin në tersi të procedurës së pranimit për emrin në pozitën *Zyrtar Ligjor 2* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, kështu që gjatë shqyrtimit të dosjes së aplikimit të ankuesit dhe kandidatëve të suksesshëm Kolegji i Këshilli, ka gjetur se ankuesi posedon Diplomën me Nr.643 të datës 05.11.2018 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti më datë 07.09.2018 ka mbaruar studimet në Fakulteti Juridik në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë duke marr titullin Bachelor në Drejtësisë, ndërsa lidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën A.GJ.I.nr.43/2020 të

datës 24.02.2020 me të cilën dëshmohet se ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një viti nga data 25.02.2019 deri më datë 24.02.2020 në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Sa i përket kandidatëve të suksesshëm Kolegji ka shqyrtuar aplikacionet e tyre dhe ka gjetur se kandidatja T.V, posedon Diplomën me Nr. 563 të datës 21.03.2019 përmes të cilës dëshmohet se e njëjta më datë 16.10.2018 ka mbaruar studimet në Fakulteti Juridik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren duke marr titullin Baçelor në Drejtësisë, ndërsa lidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën A.GJ.I.nr.66/2020 të datës 24.02.2020 me të cilën dëshmohet se ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një viti nga data 25.02.2019 deri më datë 24.02.2020 në Gjykatën Themelore në Rahovec, sipas Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta me Nr. 303 të datës 26.02.2020 ka qenë në marrëdhënie punë me Komunën e Rahovecit nga data 02.03.2020 deri më datë 02.09.2020. Kandidati A.B posedon Diplomën me Nr. 840 të datës 12.11.2021 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti më datë 30.06.2021 ka mbaruar studimet në Fakulteti Juridik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren duke marr titullin Baçelor në Juridik, ndërsa lidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën e datës 31.01.2023 me të cilën dëshmohet se ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një viti nga data 01.02.2022 deri më datë 31.01.2023 në Gjykatën Themelore në Prizren. Kandidati D.B posedon Diplomën me Nr. 719 të datës 22.07.2020 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti më datë 11.07.2020 ka mbaruar studimet në Fakulteti Juridik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren duke marr titullin Baçelor në Juridik, ndërsa lidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën e datës 31.01.2023 me të cilën dëshmohet se ka kryer praktikën gjyqësore në kohëzgjatje prej një viti nga data 01.02.2022 deri më datë 31.01.2023 në Gjykatën Themelore në Prizren. Kandidatja E.D, posedon Diplomën me Nr. 7586 të datës 03.09.2021 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti më datë 30.06.2021 ka mbaruar studimet në Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" duke marr titullin Jurist i Diplomuar-Baçelor, ndërsa lidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën SKPK/DBNJ/Nr.34 të datës 17.01.2023 me të cilën dëshmohet se ka kryer stazhin e praktikës në kohëzgjatje prej një viti nga data 01.12.2021 deri më datë 30.11.2022 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Kandidati E.V posedon Diplomën me Nr. 848 të datës 12.11.2021 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti më datë 01.10.2021 ka mbaruar studimet në Fakulteti Juridik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren duke marr titullin Baçelor në Juridik, ndërsa lidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën SKPK/DBNJ/Nr.35 të datës 05.12.2022 me të cilën dëshmohet se ka kryer stazhin e praktikës në kohëzgjatje prej një viti nga data 01.12.2021 deri më datë 30.11.2022 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Kolegji i Këshillit, bazuar në këtë konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes sikurse të ankuesit dhe kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili ka përcaktuar se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1. arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2 përvojën e punës"*.

Nga shqyrtimi i Formularit të përmbledhjeve të vlerësimeve individuale të kandidatëve lidhur me testimin me shkrim dhe me gojë për pozitën *Zyrtar Ligjor 2* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, rrjedh se ankuesi ka grumbulluar gjithsej 53.2 pikë, ndërsa kandidatja e suksesshme T.V ka grumbulluar gjithsej 83.4 pikë, kandidati A.B ka grumbulluar gjithsej 79.5 pikë, kandidati D.B ka grumbulluar gjithsej 76.4 pikë, kandidatja E.D ka grumbulluar gjithsej 72.1

pikë dhe kandidati E.V ka grumbulluar gjithsej 71.9 pikë, nga kjo rrjedh se kandidatët e përzgjedhur kanë qenë kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara, andaj nisur nga këto, Kolegji i Këshillit konstaton se në shërbimin civil emërohen kandidatë që kanë numrin më të madh të pikëve siç parashihet me nenin 40 paragrafi 1 i Rregullores 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i përcakton se: *“në Shërbimi Civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë”*, rrjedhimisht në këto pozita janë emëruar kandidatët që kanë marr numrin më të madh të pikëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën *Zyrtar Ligjor 2* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ka vepruar në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 paragrafi 1 i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”*, ngase nuk është vërtetuar asnjë shkelje procedurale dhe materiale sikurse pretendonte ankuesi dhe si e tillë ankesa e ankuesit është e pabazuar e cila është refuzuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kështu që lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër KA.Nr.18/2023 të datës 18.05.2023, përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 10.05.2023, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, pasi që ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, dhe në mënyrë të drejtë janë shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh,

nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.780/2023, datë 23/06/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës,dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.